



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:254830

Datë: 17.01.2024

Numri i dokumentit: 05200669

PPP.nr.23A/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve H . G . , A . G . 1., A . G . 2.dhe A . G . 3.nga Klina, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati N . P . nga Prishtina, ndaj debitorit Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infrakos” sh.a., me seli në Fushë Kosovë, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.300/23, të datës 09.11.2023, të Përmbartuesit Privat E . M . nga Prishtina, jashtë seance, me datë 17.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infrakos” sh.a me seli në Fushë Kosovë, i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.300/23, të datës 09.11.2023, të Përmbartuesit Privat E . M . nga Prishtina.
- II. Mbetet në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.300/23, i datës 09.11.2023, i Përmbartuesit Privat E . M . nga Prishtina.
- III. Obligohet debitori Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infrakos” sh.a me seli në Fushë Kosovë, që kreditorëve H . G . , A . G . 1., A . G . 2.dhe A . G . 3.nga Klina t’ia paguajë shpenzimet e procedurës për vendosje sipas prapësimit, në shumë prej 780 eurove.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorëve, ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.300/23, të datës 09.11.2023, në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3271/17, të datës 05.04.2019, i plotfuqishëm nga data 16.06.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 22.08.2023, me të cilin e ka detyruar debitorin

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infrakos” sh.a me seli në Fushë Kosovë që kreditorëve t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 37,643.27 euro (tridhjeteshtatë mijë e gjashtëqindëdyzetetë euro e njëzeteshtatë cent), me kamatë ligjore prej 8 %, nga data 05.04.2019 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumën prej 1,924.00 euro (njëmijëntëqindëdyzetekatër euro), si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në shumë prej 780 euro për përpilimin e propozimit për përmbarim, dhe shumën prej 370.13 euro në emër të urdhrin përmbarimor.

Debitori ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor, për shkak se sipas tij debitori ndaj këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, dhe ende nuk e ka pranuar vendimin e Gjykatës së Apelit, dhe kështu aktgjykimi i shkallës së parë nuk mund të jetë i plotfuqishëm e as i ekzekutueshëm, njëkohësisht nuk mund të ketë cilësinë e dokumentit përmbarimor.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se me rastin e inicimit të procedurës përmbarimore përmbaruesit privat i ka deponuar origjinalin e aktgjykimit C.nr.3271/17, i pajisur me vulën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë të siguruar në gjykatën e cila ka nxjerrë vendimin. Ankesa që i referohet debitori është refuzuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë AC.nr.5552/19, e datës 16.06.2023, i cili i është dorëzuar kreditorit me datë 03.08.2023, ndërsa propozimi për përmbarim i është dorëzuar me datë 09.11.2023, pra pas mbi tre muaj nga pranimi i vendimit të shkallës së dytë.

I ka kërkuar shpenzimet për përgjigje në shumë prej 783 euro.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me nenin 21 të LPP-së përcaktohet se “*Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”, ndërsa me nenin 22, paragraf 1, nënparagraf 1.1 të LPP-së përcaktohet se dokumente përmbaruese janë: “*1.1. vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese*”.

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.3271/17, të datës 05.04.2019, i plotfuqishëm nga data 16.06.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 22.08.2023, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22, paragraf 1, nënparagraf 1.1 dhe nenit 23 paragraf 1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla dhe i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragraf 1, sipas të cilit “*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbarjes së*

detyrimit”, pasi që në të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, objekti, mjetet, si dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Gjykata tutje gjeti se dokumenti përbarimor – Aktgjykimi i lartcekur, është i përbarueshëm ashtu siç përcaktohet në nenin 24 parag. 1 të LPP-së se *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përbarueshëm po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare”*, ngase i njëjti është bërë i formës së prerë nga data 16.06.2023 dhe i ekzekutueshëm nga data 22.08.2023.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret aktgjykimi i lartcekur i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36, parag. 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se *“Së bashku me propozimin për përbarim, organit përbarues i dorëzohet edhe dokumenti përbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri”*, dhe parag. 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se *“Vërtetimin për përbarueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase është dorëzuar në origjinal dhe përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përbarimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 parag. 1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Sa i përket pretendimit të debitorit se i njëjti nuk e ka pranuar vendimin e Gjykatës së Apelit me të cilin është vendosur për ankesën e këtij debitorit, dhe rrjedhimisht aktgjykimi mbi bazën e së cilit është lejuar përbarimi nuk është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm, gjykata këtë pretendim të debitorit nuk e mori për bazë për të vendosur ndryshe, sepse nga aktgjykimi i lartcekur u vërtetua se i njëjti përmban vulën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë dhe kështu është i përshtatshëm për përbarim.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, që debitori t’i bartë shpenzimet e procedurës për vendosje sipas prapësimit dhe atë duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara në shumën prej 780 euro, i referohet shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, duke u bazuar në Tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga arsyet e theksuara me lart, gjykata në bazë të nenit 73 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

PPP.nr.23A/2023, me datë 17.01.2024.

Gjyqtari

Numri i lëndës: 2023:254830
Datë: 17.01.2024
Numri i dokumentit: 05200669

Freskim Musliu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.